

Fjala e hapjes e kryetarit të ASHAK-ut, akademik Hivzi ISLAMI

Të nderuar kolegë dhe miq,

Me 2 tetor 2017 u shua njëri nga albanologët më në zë të kohës sonë, kanadezi me banim në Europë, kryesisht në Gjermani, studiuesi, përkthyesi, hulumtuesi i palodhshëm i arkivave dhe dokumenteve të hershme që dëshmojnë kulturën dhe traditën e lashtë shqiptare në këto troje, Dr. Robert Elsie, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës që nga viti 2000.

Ju ftoj që me një minutë heshtje të nderojmë personalitetin e tij!

Lavdi!

Dr. Robert Elsie ishte jo vetëm studiues dhe hulumtues i gjithanshëm, por edhe miku dhe kolegu ynë, i afërt dhe i pranishëm në shumë aktivitete të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, i angazhuar dhe i përkushtuar për të na mbajtur krahun edhe në momentet më të vështira. E kemi konsideruar gjithnjë si pjesë të rrethit tonë.

Veprimtaria e dr. Elsie-t dhe interesimet e tij për gjuhën, letërsinë, historinë dhe traditën shqiptare janë aq të gjera sa ndonjëherë kapërcenin dhe kufijtë disiplinorë. Në kërkimet e tij në arkiva dhe dokumente të hershme ai mblidhte, sistemonte dhe publikonte kontribute të veçanta, nga ato gjuhësore, historike, etnografike deri te zhvillimet më të reja të artit dhe të letërsisë sonë. Veçanërisht për ne janë të rëndësishme interesimet e tij për Kosovën, studimet e gjithanshme dhe përkthimet e autorëve tanë në gjuhë të tjera. Janë të shumtë botimet e hartuar apo të përgatitur nga Elsie që panë dritën edhe tek botuesit kosovarë në shqip, apo në gjermanisht, frëngjisht e anglisht dedikuar lexuesve të huaj apo komunitetit ndërkombëtar në Kosovë. Dr. Elsie mbetet pa dyshim përhapësi më i madh i kulturës shqiptare në botë.

Për jetën dhe veprën e dr. Robert Elsie-t do të flasë akademik Rexhep Ismajli.

04.10.2017